

Perfaqesuesja kryen stervitje shlodhëse!

nga AlbaniaSoccer

E premte, 08 Janar 2010 05:30



Diten e enjte, ekipi kombetar beri stervitje shkrythese pas ndeshjes me Adanasporin. 20 minutat e para krye vrap i lehte dhe me pas ushtrime shkrythese. Pisha, Lila dhe Muca e mbyllen stervitjen me shpejt pasi luajten nga 90 minuta ne ndeshjen e djeshme. Vila nuk u stervit me skuadren per shkak te demtimit qe pesoi me Adanaspor.

Per rreth 25 minuta Bicaj, Gocaj, dhe Samina u sterviten vecmas me trajnerin Josip Kuzhe, ndersa pjesa tjeter me trajnerin Mustedanagic, duke bere goditje te ndryshme ne porte.

Stervitja e mbasdites u zhvillua ne palester dhe pishine per lojtaret.

Ndeshja e radhes eshte caktuar qe te luhet ne fushen prane Hotel Limra ne date 9 Janar ne oren 15.00 me ekipin Siirt Jetpa, qe ndodhet ne vendin e pare i kategorise se dyte turke.

Media FSHF